



NEWSLETTER

Nëntor 2024

Nr.11

Diskutim i hapur publik për tekstet e Draft programit të punës së Agjencisë dhe Draft- planeve vjetore për kryerjen e mbikëqyrjes administrative dhe mbikëqyrjes programore për vitin 2025

Në seancën e 43-të mbajtur më 19 nëntor 2024, Këshilli i Agjencisë miratoi Draft-programin e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025. (me [Draft-programin e aktiviteteve të planifikuara](#) dhe [Draft-planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele](#)), [Draft-planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative në vitin 2025](#) dhe [Draft-planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore për vitin 2025](#).

Për tekstet e Draft- dokumenteve është hapur diskutim publik, për të cilin Agjencia fton të gjithë palët e interesuara me mendimet dhe propozimet e tyre me shkrim, të marrin pjesë në diskutimin publik dhe t'i dorëzojnë ato në mënyrë elektronike në adresë: contact@avmu.mk ose me postë në Rr. "Makedonija" nr.38, 1000 Shkup. Diskutimi publik do të zgjasë deri më 19 dhjetor 2024.

Mbikëqyrja e transmetuesve, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe ofruesve të ASHMA-së sipas kërkesës

Transmetuesit

Mbikëqyrje e rregullt programore për disa detyrime ligjore - rregullat gjatë transmetimit të komunikimeve komerciale audiovizuele, mbrojtja e të miturve nga programet që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, mendor ose moral, mbrojtja e të dhënave personale të të miturve, ofrimi i kuizeve ose formave të tjera të pjesëmarrjes në lojëra shpërblyese, përdorimi i shërbime telefonike me vlerë të shtuar dhe votim telefonik, transmetim i lojërave të fatit, përdorimi i gjuhës në programe, transmetim ditor së paku 6 orë program në televizion dhe transmetim ditor së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuele maqedonase janë realizuar mbi TV Protel, TV Due, TV News, TV Spektra, TV Svet, TV KTV, TV Edo, TV Kobra, TV Koha, TV Star dhe TV Vistel. Gjatë mbikëqyrjes janë konstatuar disa shkelje: TV Star, TV Protel, TV Due, TV News, TV Spektra dhe TV Svet kanë shkelur rregullat për mbrojtjen e publikut të mitur, në programin e TV Spektra, TV Due dhe TV KTV nuk janë respektuar rregullat për përdorimin e gjuhës në programe, përkatësisht obligimin për të transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase nuk e kanë përmbushur dhe TV News, TV Edo dhe TV Due.

Ndaj të njëjtit transmetues, është realizuar edhe mbikëqyrje e rregullt administrative lidhur me obligimet për publikim impresiu, informacioni që duhet t'u dorëzohet përdoruesve dhe për publikimin e identifikimit të transmetuesit. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se TV Due dhe TV News nuk kanë ofruar informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve, ndërsa TV News në mënyrë plotësuese nuk ka publikuar të dhënat për impresium në disa programe të transmetuara.

Mbikëqyrja e rregullt administrative është kryer mbi të gjithë 93 transmetuesit që transmetojnë program televiziv ose në radio, për detyrimin sipas të cilit transmetuesit janë të detyruar të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/redaktorët dhe burimet e financimit në periudhën e kaluar të vitit, t'i publikojnë në programin e tyre, së paku tri herë në vit, në terme të përshtatshme dhe regjistrim të informimit të dorëzojnë në Agjenci në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit. Mbikëqyrja ka konstatuar se obligimin nga neni 15 paragrafi 3 të Ligjit për Media nuk e ka përmbushur TV Kanal Vis nga Strumica.

Mbikëqyrja e rregullt administrative për përmbushjen e detyrimeve nga neni 62 paragrafi 6 të LSHMAAV dhe nenet 21 dhe 9 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio është kryer mbi TV Gurra, TV Klan Maqedoni dhe Radio Galaksi-2002. Nga mbikëqyrja është konstatuar se transmetuesit i plotësojnë kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio.



NEWSLETTER

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore mbi operatorët Makedonski Telekom, Datakom JV, Neotel për obligimin në pakon programore që e ritransmetojnë detyrimisht dhe pa pagesë përfundim të ofrimit të shërbimeve programore të shërbimit publik radiodifuziv, si dhe për obligimet për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjencion dhe titrimin e programeve që ritransmetojnë. Me mbikëqyrje u konstatua se operatori Neotel më 5 nëntor për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbimet programore "Gametoon" dhe "MTV Europe", të cilat nuk mbulohe nga çertifikata për regjistrimin e shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV.

Mbikëqyrja e rregullt programore është kryer mbi operatorët Neotel, MTEL, Nafi dhe Beko dhe Drim Sat IPTV për të përcaktuar nëse operatori ka vepruar sipas masës paralajmërim publik të dërguar për ritransmetim të shërbimeve programore që nuk janë të regjistruara në Agjencion në pajtim me nenin 141 të LSHMAAV. Mbikëqyrja rezultoi se operatorët në tërësi kanë vepruar sipas aktvendimeve dërguar nga Agjencia.

Në bazë të informacionit të dhënë nga poseduesi i të drejtave "TRING TV Albania", është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore mbi operatorin Globalsat me qëllim për të përcaktuar nëse ai ritransmeton shërbime programore nga Tring paketa, për të cilin nuk janë të rregulluara të drejta e autorit në pajtim me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Mbikëqyrja tregoi se operatori nuk ritransmeton shërbimet programore nga paketa Tring.

Ofruesit e ASHMA-së sipas kërkesës

Sa i përket obligimeve që kanë të bëjnë me transmetimin e veprave kinematografike dhe mbrojtjen e të miturve, është kryer mbikëqyrje e rregullt programore mbi ofruesit e ASHMA-së me kërkesë A1 Maqedoni, Svod Master, Makedonski Telekom dhe MTEL. Nga mbikëqyrja e kryer programore nuk janë konstatuar shkelje.

Masat e shqiptuara vërejtje publike

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën në seancën e 42-të mbajtur më 15 nëntor, shqiptoi tetë masa vërejtje publike, prej të cilave operatorit Neotel për shkak të ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk mbulohe me çertifikatë për regjistrim të shërbimit programor të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV, të TV Klan Maqedoni për shkak të informatave promovuese të pashënuara e për serialin artistik me sinjalizimin për mbrojtjen e të miturve, TV Sitel, TV Sonce, TV Shenja dhe TV Kompani 21-M për shkak të aplikimit të gabuar të sinjalistikës paralajmëruese për programin e kategorisë së dytë (8+).

Gjithashtu, për TV Kompani 21-M masë vërejtje publike është shqiptuar për mosdhënie të përkthimit në gjuhën shqipe ose maqedonisht, ndërsa për TV Shenja për mostransmetim së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

